

VENDIM
Nr. 29, datë 10.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 10.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 44 (A) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: Altin Bashli

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 377/30-2025-2655, datë 3.4.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Altin Bashli (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (*ZVRPP*), sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (*ASHK*), Drejtoria Vendore Shkodër, në detyrën e specialistit në sektorin e regjistrimit dhe të hartografisë. Për këtë, mes kërkuesit dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZQRPP*) (sot *ASHK-ja*), fillimisht, në datën 22.10.2013, është lidhur kontrata individuale e punës për periudhën e provës dhe më pas, në datën 22.1.2014, është lidhur kontrata individuale me afat të pacaktuar. Gjatë vijimit të marrëdhënieve të punës, me urdhrin nr. 463, datë 26.4.2017, të drejtorit të ZQRPP-së, kërkuesi është liruar nga detyra.

2. Duke mos qenë dakord me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë, me objekt: i. konstatimin e diskriminimit dhe viktimizimit nga ZQRPP-ja dhe ZVRPP-ja; ii. kthimin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të; iii. detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë për dëmet e pësuar nga momenti i largimit nga puna dhe deri në momentin e rikthimit në detyrë. Po kështu, kërkuesi ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit jopasuror në shumën 780.000 lekë, si dhe shpenzimet e tjera gjyqësore. Mbi bazën e kësaj kërkesëpadie, në datën 16.2.2019, në Gjykatën e Shkallës

së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është regjistruar çështja nr. 836 (21234-00311-51-10).

3. Gjatë shqyrtimit të çështjes, fillimisht, pasi ka vënë në diskutim kompetencën lëndore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 1509(6519), datë 20.12.2019, ka vendosur deklarin e moskompetencës së saj lëndore. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 887, datë 20.5.2022, me të cilin çështja është kthyer për vijimin e gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe është reregjistruar në datën 29.6.2022, me nr. 21249-01418-51-2022. Pas shortit të datës 30.6.2022, çështja i ka kaluar të njëjtit gjyqtar, por ajo (çështja) ka mbetur pa u shqyrtuar deri në largimin nga detyra të këtij gjyqtari. Më pas çështja i ka kaluar një gjyqtari tjetër, i cili gjithashtu nuk ka kryer asnjë veprim gjyqësor për shqyrtimin e saj. Më tej, për shkak të shkarkimeve, transferimeve dhe emërimeve të reja në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, çështjet janë rishortuar disa herë dhe, së fundi, çështja e kërkuarit është rishortuar në datën 28.10.2024, duke i kaluar një gjyqtari të sapoemëruar në atë gjykatë.

4. Në rrethanat kur çështja e tij nuk po shqyrtohej nga gjykata e shkallës së parë, kërkuari, në vitin 2024, bazuar në nenin 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me një kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Pas marrjes së informacionit nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për ecurinë e gjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 377/30-2025-2655, datë 3.4.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit. Ajo ka arsyetuar se, ndonëse gjykimi i çështjes ka kaluar afatin ligjor 2-vjeçar sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, kjo nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit të çështjes, por për shkak të pamundësisë objektive, si rezultat i ngarkesës së madhe, ndaj, për këtë arsye, gjyqtarit të çështjes nuk mund t’i kërkohej marrja e masave për përsheptim të procedurave, pasi ai ndjek kriteret transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve.

5. Në datën 28.8.2025 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.9.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 30.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Pas kalimit të çështjes në seancë plenare dhe pak ditë përpara zhvillimit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e ka shqyrtuar çështjen e kërkuarit dhe me vendimin nr. 71 (424), datë 4.2.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së tij.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak se çështja e tij është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë datën 16.2.2019 dhe pavarësisht se kanë kaluar mbi 6 vjet, ajo nuk është gjykuar ende.

7.2 *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi gjykatat kanë shkelur Kushtetutën, ligjet dhe legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut, duke shkaktuar pengesa për mosrealizimin e të drejtave që i takojnë atij, ndërkohë që persona të tjerë, për të njëjtën situatë, janë dëmshpërblyer.

7.3 *Standardit të arsytimit*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, jologjik dhe nuk përmban referenca në ligjin e zbatueshëm. Po kështu, ajo gjykatë nuk i referohet as praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkesës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për kohëzgjatjen e gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, por edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

11. Gjykata ka vënë në dukje se GJEDNJ-ja ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përshpejtues”, i projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar” që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Po sipas saj, ligjvënësi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, zgjidhje e cila, në parim, është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih vendimet nr. 74, datë 20.11.2025; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka përdorur mjetin parandalues/përshpejtues, por kërkesa e tij është rrëzuar me vendimin e datës 3.4.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me arsyetimin se tejzgjatja e gjykimit të çështjes ka ndodhur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i gjyqtarit të saj. Në fakt, çështja është shqyrtuar vetëm në datën 4.2.2026 dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkesës. Në këto rrethana, çështja civile e kërkesës është shqyrtuar pas gati 7 vjetësh nga regjistrimi i saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe pas më shumë se 1 viti nga përdorimi prej tij të mjetit parandalues/përshpejtues. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mjetet juridike nuk kanë qenë efektive për përshpejtimin e procedurave dhe kërkuesi nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, objekt ankimi, i është njoftuar kërkesës nëpërmjet shërbimit postar në datën 13.6.2025, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 28.8.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si dhe në drejtim të *parimit të mosdiskriminimit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, të cilat, edhe pse janë paraqitur si pretendime më vete, në thelb lidhen me mënyrën e arsytimit dhe me argumentet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Për rrjedhojë, bazuar në natyrën dhe në thelbin e këtyre pretendimeve, ato do të trajtohen në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuarisi ka pretenduar se çështja e tij është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në datën 16.2.2019 dhe se, pavarësisht se kanë kaluar mbi 6 vjet, ajo nuk është gjykuar ende. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është kontradiktor, jologjik dhe nuk përmban referenca në ligjin e zbatueshëm, si dhe se ajo gjykatë nuk i referohet as praktikës së GJEDNJ-së.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuarisi në datën 16.2.2019 dhe lidhet me një mosmarrëveshje të rrjedhur nga marrëdhëniet e punës, për shkak të ndërprerjes së saj në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi. Fillimisht, me një vendim të datës 20.12.2019, gjykata e shkallës së parë ka deklaruar moskompetencën e saj lëndore. Ky vendim i është nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Lartë, e cila, me një vendim të datës 20.5.2022, e ka vlerësuar atë të gabuar, duke vendosur që gjykimi i çështjes të vazhdojë në atë gjykatë të shkallës së parë. Më pas, pas gati 6 vjetësh nga regjistrimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, ndonëse kërkuarisi ka kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga ana e asaj gjykate dhe përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e çështjes, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, në datën 3.4.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Së fundmi, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin e datës 4.2.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit.

18. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve civile, KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin ligjor 2-vjeçar si afat referues për përfundimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së).

19. Nga sa rezulton, Gjykata konstaton se gjykimi i çështjes së kërkuarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka zgjatur gati 7 vjet nga regjistrimi i saj në atë gjykatë, duke tejkaluar dukshëm afatin ligjor referues 2-vjeçar. Për këtë arsye, fillimisht duhet vlerësuar nëse përfundimi i gjykimit nga ajo gjykatë pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual nga kërkuarisi përbën shkak për mosshqyrtimin në themel të këtij ankimi dhe, nëse jo, ky tejkalim i afatit të gjykimit duhet të vlerësohet në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për tejzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit.

20. Në lidhje me çështjen e parë, pra nëse përfundimi i gjykimit nga ajo gjykatë pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual nga kërkuarisi, pavarësisht kohëzgjatjes, përbën shkak për mosshqyrtimin në themel të ankimit kushtetues individual, Gjykata çmon se kërkesa nuk mbetet pa objekt vetëm për shkak të përfundimit të procesit në shkallë të parë, në rrethanat kur kërkuarisi synon konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe/ose pasojat që rrjedhin prej tij. Gjykata ka pohuar se qëllimi parësor i mjeteve juridike për

shkeljen e afatit të arsyeshëm është njohja e shkeljes dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përsheptimit të tij dhe, në eventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të dëmit (*shih vendimet nr. 74, datë 24.12.2025; nr. 11, datë 28.2.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuksi ruan interesin kushtetues për shqyrtim në themel, pasi verifikimi i tejzgjatjes dhe konstatimi i shkeljes, nëse provohet, mund të shërbejnë si mjete për rivendosjen e së drejtës së shkelur në aspektin kompensues, në përputhje me rregullimet ligjore përkatëse.

21. Në lidhje me çështjen e dytë, pra për sa i përket arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës së kërkuksit, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: i. sjellja e kërkuksit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuksi (*shih vendimet nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuksit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë që të justifikojë një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuksi*, në rastin konkret, për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se marrëdhëniet e punësimit janë çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” që duhet të trajtohen me shpejtësi e përparësi (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në konsideratë të kësaj jurisprudence, Gjykata vëren se, në rastin konkret, thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuksi ka të bëjë me marrëdhëniet e punës dhe me pasojat që rrjedhin prej kësaj mosmarrëveshjeje. Për këto të fundit, Gjykata ka pohuar se, për nga natyra e tyre, mosmarrëveshjet në fushën e punësimit kërkojnë vendimmarrje të përsheptuar (*shih vendimin nr. 4, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kjo çështje, për nga natyra e saj, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tilla që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, Gjykata, në kontekst të rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë ka rrezikuar kërkuksi nga vonesa në gjykim, çmon se është evidentuar rreziku për interesat e tij (kërkuksit), natyra dhe rëndësia e të cilave kanë kërkuar trajtim me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

25. Për më tepër, referuar qëndrimin të GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Gjithashtu, ajo ka theksuar se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak. Faktorë të tillë, të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të aftë, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih vendimin nr. 54, datë 9.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej gati 7 vjetësh të gjykimit të çështjes së kërkuksit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, arrin në përfundimin se kërkuksi i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Nisur nga kjo, në kushtet kur tashmë gjykimi i çështjes ka përfunduar në gjykatën e shkallës së parë, Gjykata vlerëson se nuk ka vend për të

vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 377/30-2025-2655, datë 3.4.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe urdhërimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për shqyrtimin me përparësi të çështjes. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se është rasti për konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuarit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, konstatim i cili i jep atij mundësinë për të kërkuar korrigjimin e shkeljes, sipas rregullimeve ligjore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuarit për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.3.2026.

Shpallur më 31.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska, Asim Vokshi